

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE** (ne objektin e Deges se kesaj Gjykate ne Vushtrri) gjyqtari Skender Shala, ne çeshtjen juridike te paditesve dhe te cilet i perfaqeson av. nga Mitrovica, sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurit nga Prishtine, tani me vendbanim te panjohur, te cilin i perfaqeson perfaqesuesi i perkohshem av. i nga Mitrovica, sipas aktvendimit te kesaj gjykate, per vertetim pronesie, vlera e kontesfit 3.240,00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik, te dt.27.04.2017, me daten 15.05.2017, bie kete:

### AKTGJYKIM

**I - APROVOHET** kerkespadia e paditesve dhe **VERTETOHET** se paditesi eshte pronar i pjeses se parceles kadastrale nr. me kultur are te klases II-te, ne sipërfaqe **3369 m<sup>2</sup>**, ne vendin e quajtur " " i pjeses se parceles kadastrale nr. me kulture are te klases se II-e, ne sipërfaqe prej **S= 4364 m<sup>2</sup>**, ne vendin e quajtur " " si dhe i pjeses se parceles kadastrale nr. ne kulture are, ne sipërfaqe prej **1034 m<sup>2</sup>**, ne vendin e quajtur " " paditesi eshte pronar i pjeses se parceles kadastrale nr. me kulture te klases se II-te, ne sipërfaqe **3299 m<sup>2</sup>**, ne vendin e quajtur " " si dhe i pjeses se parceles kadastrale nr. me kulture are te klases se II-te, ne sipërfaqe prej **S= 4238 m<sup>2</sup>**, ne vendin e quajtur " " dhe paditesi eshte pronar i pjeses se parceles kadastrale nr. e kulture are te klases se II-e ne sipërfaqe **3421 m<sup>2</sup>**, ne vendin e quajtur " " i pjeses se parceles kadastrale nr. me kulture are te klasese II-te, ne sipërfaqe prej **S= 4825 m<sup>2</sup>**, ne vendin e quajtur "Livasdhet" si dhe pjeses se parceles kadastrale nr. me kulture are te klaseses se II-te, ne sipërfaqe prej **875 m<sup>2</sup>**, ne vendin e quajtur " " te gjitha keto me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terrenit te ekspertizez se ekspertit gjicodet, e cila natundshmeri evidentohet ne emer te te paditurit e.

**II - OBLIGOHET** i padituri qe t'ia njohe kete te drejte paditesve dhe t'i lejoje qe paditesit kete paluajtshmeri ta regjistrojne ne emer te tyre, ne librat e tokes te Zyra Kadastrale Komonale ne Mitrovica, ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

Arsyctim

Paditesit ne padin e tyre te parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tyre ne seancat e mbajtura kane theksuar se baballaret e tyre dhe i ne vitin kane blere nga ngastren kadastrale nr. ne siperfaqe prej 10029 m2 dhe ngastren kadastrale nr. ne siperfaqe prej 1892 m2 per emimin kontraktues prej 30.000 banka te atehershme. Ndersa ne vitin nga : kane blere ngastren kadastrale 3383 ne siperfaqe prej 13193 m2 per emimin kontraktues prej 36.000 banka te atehershme, te gjitha keto Cmimi kontraktues e kane paguar ne teresi. Ne kete paluajtshmeri paditesit kane hyr ne posedim menjeher pas blerejs dhe qe nga ajo date te njejten e shfrytezojne pa pengesa nga askush. Kjo patundeshmeri tani evidentohet ne emer te te paditurit te cekur ne padi.

Pasi qe i padituri eshte ne adrese te panjohur i propozoje gjykates qe t'ia caktoj perfaqesuesin e perkohshem.

I autorizuari i paditsve ne seancen e shqyrtimit kryesor ka bere precizimin e kerkesapdise sa l perket siperfaqes, shtrirjes dhe perkufizimit te paluajtshmerise dhe ate sipas konstatimit dhe mendimit te ekspertit gjeodet kurse ne fjalen perfundimtare theksoi se nga provat e nxjerrura ne shqyrtimin e sotem ne menyre te pakontestueshme u vertetua bazushmerija e kerkesapdise. Andaj, Gjykates i propozoj qe te njejten ta aprovoj te bazuar. Gjykates I propozoj qe te bie aktgjykim me te cilin do te vertetohet se : ishte pronar I pjeses se ngastres kadastrale nr. ne siperfaqe prej 3299 m2 si dhe I pjeses se ngastres kadastrale : siperfaqe prej 4238 m2. ishte pronar I pjeses se ngastres kadastrale ne siperfaqe prej 3369 m2, I pjeses se ngastres kadastrale nr. 3383-0 ne siperfaqe prej 4364 m2 si dhe I pjeses te ngastres kadastrale ne siperfaqe prej 1034 m2 si dhe I pjeses se ngastres kadastrale nr. 3382-0 ne siperfaqe prej 3421 m2, I pjeses se ngastres kadastrale ne siperfaqe prej 4825 m2 si dhe I pjeses se ngastres kadastrale nr. ne siperfaqe prej 875 m2, me masa dhe kufij si ne skicen e terenit e cila eshte pjese e kesaj ekspertize si dhe pjese e shkresave te kesaj lende. Paditesit te drejten e pronesise e kane fituar conform nenit 20, 21, 28, 30, 72 dhe 73 te LTHMPJ. Paraardhesit e paditesve kete prone e kane blere nga paraardhesit e te paditurit per emimin e caktuar ne padi emim te cilin e kishin paguar ne teresi dhe menjeher kishin hy ne posedim duke e shfrytezuar te njejten pa nderprer qe nga momenti I blerejes dhe deri me sot ku edhe tani e shfrytezojne duke mos qene te penguar nga askush. Posedimi I tyre eshte me mirebesim dhe vecanerisht pasardhesit e tyre konsiderohen si mbajtes me mirebesim nga momenti I vdekjes se trashigimlensesve - pasardhesve te tyre, edhe me parasupozim se paraardhesit e tyre kane qene posedues-mbajtes kan qene me keqbesim. Perndryshe mirebesimi kur eshte ne pyetje posedimi gjithmon supozohet se eshte I drejte dhe valid-ligjor.

Andaj te thenat e lartecekura rezulton se paditesit jane pronar legjitim te patundeshmerive te cilat I kane nen posedim dhe I shfrytezojne, keshtu qe gjykata konsideroj se duhet te bie aktgjykim aprovues si nga propozimi I melarte.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj.



Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesit e konform nenit 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK-es, gjykata me aktvendimin C.nr.101/2016 te dt.21.01.2015, te paditurit ia caktoi Perfaqesuesin e perkohshem, av. nga Mitrovica, i cili ne baze te ketij aktvendimi do t'i ushtron te drejttat dhe detyrimet, konform nenit 82.1.2 te LPK-es.

Perfaqesuesi i perkohshem i te paditurit ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise te paditesit ne shqyrtimin kryesor theksoi se Fillimisht e kundershtoj padin dhe kerkespadin e paditesit, nuk e kundershtoj nxerrjen e provave. Nuk e kundershtoj vazhdimin e procedures se nderprere me pasardhesis e paditsve.

Gjykata seancen e shqyrtimit kryesor te dt. 27.04.2017, e mbajti ne mungese te perfaqesuesit te perkohshsem konform nenit 423,4 te LPK.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi nga keto arsye.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: ceertifikaten e pronsise me nr. te lendes procesverbalin mbi vendshiqimin C.nr.101/14 te dt.23.12.2015, ekspertizen e ekspertit i I dt. 14.01.2016, beri veshrtim ne skicen e terenit dhe kopjen e planit nga I njejt ekspert gjeodet, ndegjoi deshmitaret Mitrovices, Mitrovica dhe nga Fsh. Komuna e Mitrovices, degjoi paditesin ne cilesi te pales dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga certifikata e pronsise e cekur me lart, konstatohet se parcelat katastrale nr. dhe videntohen ne emer te te paditurit

Nga procesverbali mbi vendeshiqimin I kesaj gjykate te cekur me larte konstatohet se se paluajtshmerija kontestuese eshte e kufizuar ne te gjitha anet me prone private, paluajtshmeria ndahet ne mes me ! Ne anen Jugore paluajtshmeria kufizohet edhe me rruge 2-3 metra ( sipas ekspertit gjeodet I rruga eshte e pakategorizuar). Ne kete paluajtshmeri nuk ka objekte ndertimi, e njejt shfrytezohet per ta punuar (are) . Tani toka eshte i livruar dhe ne te gjinden grumbuj te plehrave natyrale.

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me lart, konstatohet se pas matjeve te kryera te pjeseve kontestuese te paluajtshmerive nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit, me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Kadastrit ne Mitrovica, ka vertetuar se paluajtshmerija kontestuese bjen – gjegjesisht e perbene pjeset e parcelave te cekura me larte me masa dhe kufij te shenuara si ne ekspertizen e dhene me shkrim dhe ne skicen e terenit, e cila eshte pjese perberse e kesaj ekspertize dhe te aprovuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga skica e terrenit e sipërcekur shifet shtrirja, vendi, perkufizimi dhe sipërfaqja e paluajtshmerise tani lendore.

Deshmitari deklaroi se une personalisht e di se paraardhesi i paditesve me emrin [ ] e ka blere nga nje person I kombesise serbe emri i te cilit nuk me kujtohet ne vitin sakte nuk me kujtohet kur e kane blere por une kam qene ne moshen 7 vjecare e tani i kam 77 vjet, paraardhesit e paditesve kane qene duke e punuar ate toke sa i perket sipërfaqes nuk e di sakte por e di se eshte are e madhe (disa hektar). Sa I perket pagimit te emimit te shitblersjes une nuk e di a i kane paguar edhe kujna I kane paguar se eshte shume kohe e gjate. As a kane nenshkaruar ndonje kontrat me shkrim me ta nuk me kujtohet apo e kane blere me marreveshje me goj. Ne ate paluajtshmeri as paraardhesit e paditesve e as tani paditesit kurrnjeher nuk kane ndertuar shtepi ne ate vend, por ka qene toke te cilen ata e kane punuar. Ate toke ata e kane punuar duke mbjelluar here kallamoq e here grun. Ajo toke nuk ka qene kurr e rrethuar por e njejta ka qene e ndame me gure te megjes. Une kete fakte e di nga se une e kam token time ne megje me kete paluajtshmeri – token e tyre, prej moshes 7 vjecare kur jam ba me dite e kam shkuar ne ate toke e deri me sot, une nuk kam degju e as nuk e di se paraardhesit e paditesve e as tani paditesit qe kane pas ndonje penges apo kundershitim prej dikujte ne shfrytezimin e posedimin e asaj toke. Keto rrethana me jane te njohura sepse sic e ceka edhe me latrte, une i kam kojshi me toke vetem megja me dane me token e tyre dhe se mund te ju them se si kojshi jane shum te mire dhe kurr nuk kemi pas problem me ta.

Deshmitari deklaroi se personalisht e di se qe nga viti [ ] kur une e kam blere nje parcele afer tokes se tani paditesve e di se aty kane qene prej ati viti e edhe sot e punojne ate toke. Sa I perket ceshtjes se prej kujt e kane blere emrin dhe mbiemrin si dhe vitin kur e kane blere dhe se a ia kane paguar te hollat shitsit kete ceshtje nuk e di, por e di sic kam degjuar prej tjerve e kane blere prej serbve. Per sa e di une qe nga viti [ ] kur une kam filluar ta punoj token time te njejtit nuk kane pasur asnje penges per shfrytzimin dhe posedimin e asaj toke bile vitin e kaluar e kam pas te mbjellur miser kurse kete vit me grune. Keto rrethana me jane te njohura nga se une sic e ceka me larte e kam token ne megj me ta dhe se si njerz si kojshi jane shume te mire.

Deshmitari deklaroi se personalisht e di se para 76 viteve une kam shkuar per ta punuar token e babes tim dhe prej ateher e di se baballaret e tani paditesve emrat i kane pasur Sali dhe Hajdar e kane punuar ate toke. Nuk e di se prej kujte e kane blere token e as a kane perpilu ndonje kontrat me ta, por e di se para 76 viteve kur une kam shkuar ne ate toke per ta punuar as baballaret e tani paditesve e as paditesit, kurr njeher nuk kane qene te penguar nga askush ne shfrytezimin dhe posedimin, por e kane punuar cdo vit, her kan mbjelluar grun e her kollomoq. Siperfaqja e saj nuk me kujtohet, por e di se eshte siperfaqja madhe me hektar. Per sa e di une kurr njeher nuk kemi pas problem me ta sa i perket problemeve me megje e as si kojshi. Prej se e mbaj mend une, Hekurudha e ka nda ate toke te paditesve. Keto rrethana me jane te njohura sepse une prej para 76 viteve I kam ne megje me toke.



Paditesi ne cilesi te pales deklaroi se paluajtshmerin e cila eshte objekt shqyrtimi e ka blere babai im ndjer nga shitesit te cilin e kane thirur emnin e ka pasur aty diku ne vitin ne siperfaqe rreth dy hektar e gjysme. Une kam qene ne moshen 16 vjecare dhe e mbaj mend shume mire. Njeher baba im e ka blere pjesen e tokes mbi hekurudh prej ne shume prej 30 mije bank ate atehershem. Ndersa pjesen nen hekurudh pas nja 10 viteve baba im me vellaznin e tij e ka blere prej emrin e ka pasur ne shume prej 26 mije banka te atehershem. E di dhe jam I sigurte se babai im se bashku me vellezerit e tij dhe ia kane paguar per te dy pjeset shitesve te gjitha te hollat per blerjen e tokes. E di se pjesen qe e kane blere prej nuk kane nenshkruar kurrfar kontrate por jane marre vesh vetem me goje, ndersa pjesen qe e kane blere prej e di se e kane pas nenshkruar nje kontrate te avokati por e njejtja na u ka djege ne lufte. E di se dhe kane qene vella dhe moter, bile per sa e di une a nuk ka qene asnjeher e martuar. Token te cilin e kane blere paraardhesit tane ka qene e tera vetem are, nuk ka pas kurrfar shtepie te ndertuar ne te, te njejten e di se prej ateher e ka nda hekurudha. Te njejten edhe te paret tane edhe ne me se shumti e kemi mbjellur kallamoq edhe grun. Une e di dhe jam I sigurt se prej vitit prej kur eshte blere kjo toke e deri me sot, asnjeher nuk kemi pasur pengesa as ne e as te paret tane nga askush lidhur me posedimin dhe shfrytezimin e kesaj toke. Ajo toke nuk ka qene kurnjeher e rrethuar e as sot nuk eshte e rrethuar, por e njejtja eshte e kufizuar me gure te megjes.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me lart, gjykata erdhi ne perfudim dhe konstatoi se paraardhesit e paditesve e fituan te drejten e pronesise ne pjeset e parcelave kadastrale nr. dhe ne baze te marreveshjes gojore ne mes te paraardhesve te tyre dhe shitesve - paraardhesve te tani te paditurit

dhe ngastren kadastrale nga .  
ne baze te marreveshjes me shkrim e cila sipas deklarates se paditesit Vehbi Sylejmani te dhene ne cilesi te pales eshte djegur gjate luftes, duke ia paguar emimin kontraktues shitesve dhe duke e shfrytezuar kete padundeshmeri me gjate se 20 vite, kohe kjo e parapare per fitimin e te drejtes se prones me parshkrim fitues, konform dispozites se nenit 28 par.4 te lidhur me nenet 20, 21, 30, 72 dhe 73 te LTHMPJ Ligjit mbi Marredheniet Themelore Juridike - Pronesore.

Paditesit perkatesisht paraardhesit e tyre te drejten e pronesise ne kete patundeshmeri e kishin fituar edhe konform nenit 73 te Ligjit per Marredheniet Detyrimore dhe ate me shkrim te lidhur ne mes tyre dhe - paraardhsve te tani te paditurit e kishin permbushur ne teresi, pasiqe e kishin paguar emimin kontraktues dhe poashtu kishin hyr ne posedim dhe shfrytezim te kesaj patundeshmerie menjeher pas blerjes se te njejtes.

Kete gjendje te tille faktike gjykata e vertetoi edhe ne baze te deshmive te deshmitareve ja fsh. nga dhe i nga Fsh, Komuna e Mitrovices si dhe ne baze te deshmive te dhene nga paditesi e cilesi te pales, te dhena nen betim, te cileve ua fali besimin, pasi qe te njejtat ishin bindese dhe ne harmoni me kerkespadine, e veqanrisht sa i perket pagimit te qmimit kontraktues si dhe aspektit kohor te posedimit dhe shfrytzimit te palujtshmerise pa pengesa nga ana e paraardhesve te paditsve dhe tani vet paditsve.


Gjykata ne kete rast i aplikoi dispozitat e LMTHJP –se dhe LMD-se nga se raporti juridik konkret i qeshtjes kontestimore eshte sajuar ne kohen kur ne aplikim kane qene ligjet e lartecekura.

Vendimin qe secila pale ti barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore, bazohet ne baze te 459.1 te LPK-se.

Nga permbledhja e fakteve dhe arsytet ligjore te cekura me lart, konform nenit 143.1 te LKK –se, u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**  
**C.nr.203/2016, dt.15.05.2017.**

Gjyqtari,  
 Skender Shala



**KESHILLE JURIDIKE:** Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa, ne afatin prej 15 (pesembdhjet) diteve, nga dita e pranimet, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA



VENDIMI ESHTË I PËRIRREVOKUESHËM  
 QËLINDA JE NEHYRËSHMËZËNA  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 MITROVICA MITROVICA

Më  
 Data

19.06.2017

